

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Bazat e kontabilitetit
Niveli:	Bch
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri II-Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Skender Ahmeti
Detajet kontaktuese:	skender.ahmeti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë është e dizajnuar për të siguruar një kuptim themelor të kontabilitetit dhe mbulon tema të ndryshme, përfshirë teorinë bazë të kontabilitetit, parimet e kontabilitetit, përgatitjen e llogarive dhe procedurat për të regjistruar transaksionet e biznesit, njohjen e elementeve të kontabilitetit dhe përgatitjet e pasqyrave financiare. Më e rëndësishmja, studentët do të mësojnë se si ndihmojnë informatat e kontabilitetit përdoruesit e pasqyrave financiare në lehtësimin e vendimmarrjes së tyre.
Qëllimet e lëndës	Kontabiliteti është gjuha e biznesit, duke lehtësuar komunikimin e aspekteve financiare të biznesit. Prandaj, lënda ka për qëllim sigurimin e një prezantimi të kontabilitetit për studentët pa njohuri paraprake, përgatitjen e studentëve për studime të mëtejme në këtë fushë, pajisja e studentëve me njohuri lidhur me regjistrimin e ngjarjeve ekonomike dhe përdorimin e tyre drejt përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe interpretimin e tyre dhe përdorimin me qëllim të vendimmarrjes ekonomike. Pasqyrat financiare të njësive të ndryshme ekonomike do të merren si shembuj praktik. Studentët do të inkurajohen për mendimin kritik mbi problemet dhe sfidat që lidhen me çështjet e kontabilitetit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas kompletimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - Të kuptojnë terminologjinë e kontabilitetit dhe konceptet themelore të kontabilitetit; - Të kuptojnë se kush janë përdoruesit e informacionit që rrjedh nga kontabiliteti dhe arsyen e përdorimit; - Të kuptojnë thelbin e regjistrimit të dyfishtë dhe arsyen e përdorimit të kësaj baze kontabiliteti; - Të kenë njohuri lidhur me ditarin, llogaritë dhe të ndërtojnë bilancin provues; - Të kuptojnë llogaridhënien e elementeve të përbashkëta të pasqyrave financiare dhe të përgatisin pasqyra financiare; - Të lexojnë, interpretojnë dhe analizojnë pasqyrat financiare.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	2	15	30
Ushtrime praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	20	20
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet, etj			
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Procesi i mësimdhënies kryesisht do të mbështetet në metodën biseduese dhe argumentuese. Kjo metodë supozon se studentët paraprakisht janë të vetëdijshëm për temën që do të shtjellohet dhe vijnë të përgatitur në klasë. Këto do të realizohen në aspektin teorik dhe praktik, duke ofruar njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Ndërkaq, pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të zhvillimit të aktivitetit ekonomik të njësive ekonomike. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor–student si dhe ai student-student.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Nota finale do të bazohet në shpërndarjen e mëposhtme: Vlerësimi i parë periodik nga lënda: 20% Vlerësimi i dytë periodik nga lënda: 30% Vlerësimi i tretë periodik nga lënda: 30% Detyra dhe prezantime/seminare: 10% Participime dhe angazhime: 5% Vijueshmëria: 5% Provimi final <u>Vlerësimet periodike</u>: pritet që ju të merrni pjesë në vlerësimet sipas kohës së planifikuar. <u>Detyra dhe prezantime/seminare</u>: kërkohet që ju të merrni pjesë në projektet e grupit. Gjithë grupi duhet të kontribuojë në prezantimet e njëri-tjetrit, në mënyrë që t'i shprehni pikëpamjet tuaja lidhur me çështjet për diskutim. Pjesëmarrja e rregullt në diskutime dhe të qenit aktiv do të ju mundësojë të merrni edhe 5% bonus në vlerësimin përfundimtar. <u>Vijueshmëria</u>: pjesëmarrja e rregullt në ligjërata do të konsiderohet si kritike. Maksimumi i ligjëratave që ju do t'i humbni dhe akoma do ta merrni 5% është dy.</p>		

	Shkallët e notave:
	91-100% nota 10 (dhjetë)
	81-90% nota 9 (nëntë)
	71-80% nota 8 (tetë)
	61-70% nota 7 (shtatë)
	51-60% nota 6 (gjashtë)
	50-me pak nota 5 (pesë)

Literatura	
Literatura bazë:	Skender Ahmeti, Prof.Dr., Kontabiliteti Financiar, (koncepte themelore) Prishtinë, 2012 Rrustem Asllanaj, Prof.asoc.Dr., Kontabiliteti financiar”, Prishtinë, 2013
Literatura shtesë:	Shfrytëzoni SEMS-in për materialet e vendosura nga bartës i lëndës Peter Atrill and Eddie McLaney, Financial Accounting for Decision Makers, sixth edition. Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në kontabilitet; Bizneset dhe llojet e tyre; Kontabiliteti-gjuhë e biznesit; Llojet e kontabilitetit dhe karakteristikat e tyre; Përdoruesit e informacionit të kontabilitetit dhe grupet e interesit; Kuadri rregullativ.
Java e dytë:	Prezantimi i pasqyrave financiare dhe karakteristikat cilësore të tyre; Elementet kryesore të pasqyrave financiare.
Java e tretë:	Ekuacioni i kontabilitetit dhe parimet e regjistrimit të dyfishtë; Njësitë e procesit kontabël-llogaritë dhe funksionimi i tyre; Rregullat e debitimit dhe kreditimit të llogarive;
Java e katërt:	Detyra praktike dhe shembuj lidhur me ndërtimin e pasqyrave financiare dhe sistemin e regjistrimit të dyfishtë.
Java e pestë:	Vlerësimi i parë periodik nga lënda
Java e gjashtë:	Ndërtimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare; Bilanci i Gjendjes, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Java e shtatë:	Ndërtimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare; Pasqyra e ndryshimit të kapitalit, Pasqyra e rrjedhës së parasë, Shënimet e dhënies së informatave shpjeguese.
Java e tetë:	Ditari dhe bilanci provues; Evidenca kronologjike e transaksioneve në ditar, bartja e tyre në llogaritë e librit kryesorë (të madh), mbyllja e llogarive, ndërtimi i bilancit provues dhe bartja e elementeve të tij në pasqyra financiare.
Java e nëntë:	Detyra praktike dhe shembuj lidhur me regjistrimin e transaksioneve ekonomike.
Java e dhjetë:	Vlerësimi i dytë periodik nga lënda
Java e njëmbëdhjetë:	Kompletimi i ciklit të kontabilitetit-Akrualet dhe Shtyrjet. Kontabiliteti i veprimeve tregtare; Blerjet dhe shitjet e mallrave; Kthimet dhe zbritjet në blerje dhe shitje të mallrave.

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kontabiliteti i inventarit të mallit dhe KMSH; Sistemet e inventarizimit të mallit; Kalkulimi i KMSH dhe metodat e vlerësimit të inventarit.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Llogaritë e arkëtueshme, vlerësimi i llogarive të arkëtueshme, dëftesa e arkëtueshme, shpenzimet për borxhet e këqija dhe metodat për llogaritjen e tyre.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Detyra praktike dhe shembuj lidhur me regjistrimin e akrualeve, shtyrjeve, blerjet dhe shitjet e mallrave, inventari dhe borxhet e këqija.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat që do t'u jepen. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet ta respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentin duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.